



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ÇËRRIK

Data 22.01.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Karburant per vitin 2025 per Bashkine Cerrik”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09134100-8
karburant

VLERA E FONDIT LIMIT: 9166667 (nente milion e njeqind e gjashtedhete e gjashte mije e gjashteqind e gjashtedhete e shtate) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Cerrik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Leje tregtimi ose autorizim për tregtim karburanti e leshuar nga organet perkatese, mbeshetur ne Ligjin nr.8450, date 24.02.1999 “ Për përpunimin, transportimin e naftes dhe nenprodukteve te tjera” me ndryshimet perkatese .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si neneve 19, 20 dhe 21 të Ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, dhe Kreut II të VKM-së nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të vënë në dispozicion

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2.2.3 Vertetim per shlyerjen e taksave vendore te parashikuara nga Pushteti Vendor per vitin 2024, ,sipas përcaktimeve të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet, nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Per te provuar pervojen e meparshme operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizime te ngjashme ne nje vlere jo me te ulet se 20% te fondit limit pa TVSH-, te realizuara (nga subjekti juaj) ne tri vitet e fundit financiar nga data shpalljes se njoftimit te kontrates..

Per kete rast te paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika

4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. (lidhur me procedurën e hapur të thjeshtuar).

2.3.2 Specifikimet teknike dhe kërkesa për Diesel 10 PPM duhet të jenë sipas Standard-it SSH EN 590 2018

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 2 stacione tregtimi karburanti në territorin e bashkisë Cerrik të vertetur me Niptin perkates dhe të pasqyruara në ekstraktin e shoqërisë për vitin 2024, këto stacione të jenë të pajisura me vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), dhe police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave si dhe Leje mjedisore Tipit B leshuar nga QKB si dhe akt miratimi i Projektit Teknologjik për të dyja stacionet.

Argumentimi: Ky kriter është vlerësuar i nevojshëm nga ana e njësisë së prokurimit pasi i shërben autoritetit kontraktor për të vërtetuar nëse operatori ekonomik i suksesshëm ka kapacitetet e duhura për të Garantuar furnizimin me karburant 24 orë, në një distancë relativisht të përballueshme për Institucionin.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë ISO 9001:2015, (për të vërtetuar që operatori i plotëson kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë) leshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim, , e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë ISO 14001:2015, (për të vërtetuar që operatori i plotëson kërkesat për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit) leshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.
- Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën ISO 18001: 2007 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë e cila të përfshijë objektin e prokurimit si edhe të jetë e vlefshme.
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë për sistemin e integruar BS PAS 99: 2012:

Argumentimi : Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë”

së furnizimit me mallra që ofron. Menaxhimi i cilësisë i certifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit. Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoritetet në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në teresi. ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanimit në njohur si standarti që i perket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

EN- ISO 14001-2015- Ky kriter kërkohet që OE të jetë i certifikuar sipas standartit ndërkombëtar që produktet apo pajisjet e sjella janë të garantuara në cilësi dhe nuk kanë ndikim në mjedis.

BS PAS 99: 2012- (një standard për shkrimin e standardeve të sistemit të menaxhimit të) i bazuar në gjashtë kushtet e përgjithshme, është një specifikim i integruar i parë kërkesat e sistemit të menaxhimit të botës.

Standard mundëson për të shfaqur veprimet aktivitetet dhe procedurat më efektive të zhvilluara në përgjigje të kërkesave të tregut drejt shkrirjes në një strukturë të vetme.

Sistemi i Menaxhimit të Integruar më shumë se një sistem i menaxhimit, i cili është i gjithë sistemi i institucioneve të formuara duke sjellë së bashku. Certifikimi Menaxhimi i Integruar i tregon OE mund të permbushë të gjitha detyrat sipas kërkesave.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Fletë Analiza të lëshuar nga ISHTI për produktin Diesel 10 sipas standartit PPM SSH EN 590 2018.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe gërmën c pika 6 të nenit 40 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Ky kriter vendoset pasi AK kërkohet të garantohet që karakteristikat teknike të mallit të ofertuar të përputhen me standartet teknike të kërkuara.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me certifikate regjistrim marke lëshuar nga Drejtoria e përgjithshme e Patentave dhe markave për logon dhe marken që përdor për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe nenin 79, të Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.8 Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në çdo stacion furnizimi të tij, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të AK (ose bot në zyren qendrore të AK) sipas kërkesave të AK. Lista e automjeteve, Tipi dhe Targa e secilit automjet do të jenë pjesë e kontratës së fituesit, me AK.

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant, detyrimisht me pistoletë publike.

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të AK.

Argumentimi : *Kriteri i mësipërm vendoset në mbështetje të pikës 8 të nenit 40 të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Ky vetdeklarim i nevojitet autoritetit kontraktor për tu garantuar nga ana e operatorit ekonomik të suksesshëm që do të sigurojë vijueshmëri në furnizimin e mallit në stacionet e shitjes së operatorit ekonomik brenda 24 orëve, përgjatë gjithë periudhës së kontratës pa nxjerrë pengesa.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera mbi 2 autobote të transportit të lendeve të rrezikshme me kapacitet mbajtës nga 2000 litra deri në 20‘000 litra. Autobote duhet të jenë të pajisur me leje qarkullimi, Kolaudimi (SGS), police sigurimi, certifikate për transportin e mallrave të rrezikshme dhe pasaporta e mjetit lidhur me kapacitetin e mbajtjes

Shenim: Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, nenit 26 pika 2/i e VKM nr.285 datë 19.05.2021 si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26 të VKM-se , ku parashikohet: *“Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.*

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:

“ Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 92 parashikon shprehimisht se *“Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.”*

“ Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se *“Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik”*

Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “ Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: *“Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim.”*

Ligji nr.118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”.Kriteri per autobotet gjithashtu i sherben autoritetit kontraktor pasi përveç furnizimit me naftë në pikat e shërbimit nëpërmjet paraqitjes së kartave elektronike, e cila do të shërbejë kryesisht për furnizimin me karburant të automjetit të institucionit, ka të nevojshme dhe furnizimin me karburant të pajisjeve të tij s kaldaja. Sqarojmë se autoriteti kontraktor furnizon me karburant per ndezjen e kaldajave edhe disa shkolla te cilat jane ne territorin e bashkise Cerrik .Këto godina për funksionimin normal të tyre kanë nevojë për furnizim me karburant për kaldajat në secilin prej tyre.

2.3.10 Subjekti duhet te deklarojese disponon stacione tregtimi me pakice ne akset kryesore te qytetit te Elbasanit si : Aksi Elbasan –Librazhd Elbasan- Cerrik Elbasan – Tirane keto stacione tregtimi karburanti te jene te pasqyruara ne ekstraktin historik te shoqerise si dhe te vertetuara me nje nga format e posedimit akt noterial kontrate qeraje ose akt pronesie.

Argumentimi : *Kriteri i mësipërm vendoset në mbështetje të pikës 8 të nenit 40 të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*

2.3.11 Bazuar ne VKM-ne nr. 561 date 29.07.2016 „ Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshme“ Operoret Ekonomike pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi (Webpage) ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepermjet kartes elektronike.

Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofroje edhe sherbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit Kontraktor , sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike te cilat ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate mjet.

Argumentimi : *Kriteri i mësipërm vendoset në mbështetje të pikës 8 të nenit 40 të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*

2.3.12 Operatori ekonomik duhet te ofroje furnizimin me karburant me karte elektronike, e cila duhet te jene pa skadence dhe te jete e perdorshme dhe gjate vitit 2024 ne perputhje me Vendimin e keshillit te Ministrave nr. 561 date 29.07.2016 „ Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshme.

Argumentimi : *Kriteri i mësipërm vendoset në mbështetje të pikës 8 të nenit 40 të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. VKM nr 561 date 29.07.2016(Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme , ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike)*

2.3.13 Oferta e paraqitur nga OE duhet te jete e shprehur ne norme fitimi per liter

Argumentimi : Kriteri i mësipërm vendoset në mbështetje të pikës 2.1/c të nenit 45 të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;

b) elementet fiskale;

c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës* .

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Hartimi i specifikimeve teknike të Gazoil (Diesel 10 ppm) është bërë në përputhje me kërkesat që përcakton Ligji nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” si dhe sipas Standardeve Shtetërore në fuqi që ato duhet të plotësojnë, të jetë sipas Standard-it SSHEN.

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara		Metoda e provës
		minimale	maksimale	
Numri i cetanit ^b		51,0	-	EN ISO 5165
Indeksi i cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	820	845	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarburët aromatikë policiklikë ^{d,e}	% (m/m)	-	11	EN 12916
Përmbajtja e squfurit ^f	mg/kg	-	350 (deri 31-12-2004) ose 50,0	EN ISO 20846 EN ISO 20847 EN ISO 20884
			10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884
Pika e flakërimit	°C	mbi 55	-	EN ISO 2719
Përmbajtja e koksit ^g	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370

(në 10 % mbetje distilimi)				
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Ndohtja e përgjithshme	mg/kg	-	24	EN 12662
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësim	klasa 1		EN ISO 2160
Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³	-	25	EN ISO 12205
Vetitë lubrifikuese, diametri i korrektuar i njollës së gripuar (gërryer) (wsd 1,4) në 60 °C	µm	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50	EN ISO 3104
Distilimi ^{h, i}				EN ISO 3405
distilati që vlon ÷ në 250°C,%(v/v)	% (V/V)		< 65	
distilati që vlon ÷ në 350 °C, % (v/v)	% (V/V)	85		
distilati që vlon në 95 % (v/v)	°C		360	

Njesia e prokurimit
